

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " RUBIX SPORT KLUB " Sh.p.k**

Ne Tirane, sot me date 06.09.2022(dymije e njezet e dy), nenshkruhet ky Akt Themelimi i Shoqerise " **RUBIX SPORT KLUB**" Shpk nga: "**Rubix Hollding Group**" sh.p.k. shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar si person juridik prane qendres kombetare te regjistrimit Tirane me **NUIS M21508003D** me adrese. **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane.** E cila, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " **RUBIX SPORT KLUB**" Shpk.

#### **Neni 1**

##### **Forma e shoqerise**

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te Shoqerise, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

#### **Neni 2**

##### **Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise eshte " **RUBIX SPORT KLUB** " Sh.p.k.

#### **Neni 3**

##### **Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit te Themelimit.

#### **Neni 4**

##### **Objekti i veprimtarise**

Veprimtaria e Shoqerise " **RUBIX SPORT KLUB**" Shpk do te ketë për objekt: Organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit të futbollit dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga Federeta Shqiptare e Futbollit, si dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga UEFA, krijimin e cdo lloj veprimtarie sportive ate Akademisë së Futbollit dhe te Basketbollit, Volejbollit etj **RUBIX SPORT KLUB**, ku përfshihen të gjithë ekipet zinxhir të sportit të futbollit, futja në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të shitblerjes së lojtarëve, kuotimi në indekset e bursave kombëtare apo ndërkombëtare, aktivitete të tjera në fushën e sportit të futbollit, çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Selia**

Selia e Shoqerise " **RUBIX SPORT KLUB**" Shpk eshte ne adresen: **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane. Shqiperi.**



## **Neni 6**

### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

## **Neni 7**

### **Kapitali i shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise " **RUBIX SPORT KLUB**" Shpk eshte 10 000 (dhjetemije) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktimeve ligjore. Kapitali do të ndahet në 1 (nje) kuot. Ky kapital është formuar nga themeluesja e shoqërisë si më poshtë: "**Rubix Holding Group**" **sh.p.k.** me 10 000 (dhjetemije) leke duke zotëruar 100 % të kuotave 1 (nje kuot).

## **Neni 8**

### **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem me nje mandat 5(pese) vjecar.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. **Edmond Petraj**

Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

## **Neni 9**

### **Te ardhurat**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se vitit ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

## **Neni 10**

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykatat e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen Shqipe dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

### **ORTAKET THEMELUES:**

**"Rubix Holding Group"**

**Administratori Edmond Petraj**

